

Mbi auditimin e ushtruar në Degën Doganore Tiranë

Raporti përfundimtar i auditimit të ushtruar në Degën Doganore Tiranë, “Mbi zbatimin e legjislacionit doganor në procesin e realizimit të të ardhurave doganore dhe vlerësimin e veprimtarisë ekonomiko-financiare” për periudhën viti 2014 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 112, datë 08.09.2015.

Bazuar në nenet 15, 25 dhe 30 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, me shkresat nr. 409/13 dhe nr. 409/14, datë 08.09.2015, për znj. Pranvera Fagu (Behushi) me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i Doganave dhe z. Mirarbër Teneqexhiu me detyrë Drejtor i Degës Doganore Tiranë, i janë dërguar “Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe rekomandimet”.

Kontrolli i Lartë i Shtetit ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Nga auditimi i procedurave të zhdoganimit dhe klasifikimit tarifor të mallrave rezultoi se autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Tiranë gjatë vlerësimit doganor të mallrave me metodën e transaksionit ka pranuar dokumente fotokopje si për deklaratat e eksportit, faturat, CMR, çertifikat origjine, si dhe në raste të veçanta EUR 1, duke vepruar në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 33-37, dhe kërkesat e udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 25 datë 30.11.2007 “Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore burimet e informacionit dhe afatet e publikimit të dosjes me të dhëna të disponueshme, si dhe zhdoganimit të automjeteve dhe pjesëve të këmbimit”, për pranimin e metodës së transaksionit në vlerësimin doganor, *trajtuar më hollësisht në faqet nr. 18-56, të RPA-t.*

Për këtë është rekomanduar që, Autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Tiranë të marrë masa të menjëhershme për ndalimin e praktikave të pranimit të dokumenteve fotokopje gjatë vlerësimit doganor të mallrave, me metodën e transaksionit, si dhe të plotësohen dosjet e praktikave me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për një vlerësim doganor korrekt.

Menjëherë

2. Nga auditimi i procedurave të zhdoganimit dhe klasifikimit tarifor të mallrave rezultoi se autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Tiranë në rastet e debatueshme të rivlerësimit doganor të mallrave të importuar nga operatorë të ndryshëm ekonomik nuk disponon praktika të plota me dokumentacion mbështetës për sa pretendojnë mbi ekzistencën e dokumentave origjinale të faturave të mallrave, deklaratat e eksportit nga vendi importues, sëift bankar, apo edhe informacion mbi investigimet e kryera nga strukturat e specializuara doganore në origjinë, ndërkohë që konstatojmë se edhe ato pak praktika të krijuara, nuk janë të inventarizuara dhe të arkivuara në përputhje me kërkesat e legjislacionit arkivor shqiptar, *trajtuar më hollësisht në faqet nr. 18-56, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Për këtë është rekomanduar që, Autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Tiranë të marrë masa konkrete për krijimin dhe plotësimin e praktikave (dosjeve të posaçme) për secilin nga operatorët ekonomikë që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin doganor Tiranë si dhe të realizohet inventarizimi dhe arkivimi i tyre duke lehtësuar në këtë rast kontrollin dhe auditimin e zbatimit të ligjshmërisë në klasifikimin doganor.

Në Vijimësi

3. Nga auditimi i dokumenteve të paraqitura nga Dega e Doganës Tiranë, lidhur me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit në auditimin e mëparshëm rezultoi se i ka rekomanduar për zbatim DDT, 13 masa organizative, 8 masa shpërblim dëmi, 8 masa disiplinore, dhe 5 masa administrative.

Nga auditimi i ushtruar në DDT u konstatua se; nga 13 masa organizative janë zbatuar plotësisht 7 masa, pjesërisht 5 masa dhe nuk është zbatuar 1 masë, nga 8 masa shpërblim dëmi është zbatuar 1 masë, pjesërisht 6 masa dhe nuk është zbatuar 1 masë, nga 5 masa administrative të rekomanduara janë zbatuar 5 masa, *trajtuar më hollësisht në faqet nr. 15-16, të RPA.*

Për këtë është rekomanduar që, Autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Tiranë të marrë masa për zbatimin e rekomandimeve nr. 1, 3, 5, 9, 10, të zbatuara pjesërisht dhe nr. 12, i pa zbatuar tek masat organizative si dhe rekomandimet nr 1, 2, 3, 4, 6, të zbatuara pjesërisht dhe nr. 8 i pa zbatuar për shpërblim dëmi në vlerën **20,438 mijë lekë**, rekomanduar për zbatim nga KLSH, në auditimin e mëparshëm.

Menjëherë

4. Nga auditimi i ushtruar mbi programimin dhe realizimin e të ardhurave doganore u konstatua se nuk ka një person të ngarkuar për përpunimin dhe administrimin e të dhënave statistikore të domosdoshme për përgatitjen e raporteve për analizat që kryen autoriteti doganor kompetent me qëllim realizimin e një ndër funksionet kryesore të doganës, realizimin ritmik të të ardhurave doganore të programuara, si dhe raportimin jo vetëm në kohë por edhe në mënyrë sa më të saktë të tyre, veprim që bie ndesh me dispozitat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “ Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 11 pika 2, si dhe të Rregullores së Brendshme të Degëve Doganore, miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave me shkresën nr. 19095/2, datë 12.11.2012, neni 14, pika 7, *trajtuar më hollësisht në faqet nr. 16-18, të RPA.*

Për këtë është rekomanduar që, Autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Tiranë të marrë masat e duhura për caktimin e një punonjësi përgjegjës për administrimin e të dhënave statistikore që gjenerohen nga kjo doganë. Raportet dhe analiza e të dhënave mund të përdoren nga Sektori Analizës së Riskut për të rritur efektshmërinë e ndërhyrjeve operacionale.

Në Vijimësi

5.1 Nga auditimi i dokumentacionit të administruar nga Zyra e Mbikëqyrjes së Regjimeve të Përpunimit Aktiv dhe Magazinave Doganore u konstatua se gjatë vitit 2014 nuk janë kryer inventarë fizikë (vjektor) në ambientet e operatorëve ekonomik, fakt që ka sjellë mos realizimin e rakordimeve midis gjendjes së mallrave nga inventari fizik me gjendjen e pasqyruar në kontabilitet, duke lënë hapësira për evazion fiskal. Konstatohet se megjithëse shumica e subjekteve nuk i kanë pasqyrojnë inventarët në përputhje me formatin standard të miratuar nga Zyra e Mbikëqyrjes së Regjimeve nuk është vepruar për të marrë masa konkrete për përmirësimin e gjendjes, veprime që bien ndesh me kërkesat e Kodit Doganor si dhe kërkesat e udhëzimit nr. 3, datë 09.02.2006 të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave “Për zbatimin praktik të përfitimit dhe operimit me regjimin e magazinimit doganor”, si dhe kërkesat e udhëzimit nr. 1, datë 06.09.2012 të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave “Për zbatimin praktik të regjimit të përpunimit aktiv”, neni 6 mbikëqyrja doganore dhe kontrolli i regjimit, pikat 1, 2 dhe 4, paragrafët 4.1 dhe 4.2, *trajtuar më hollësisht në faqet nr. 135-149, të RPA.*

5.2 Nga auditimi u konstatua se dosjet e operatorëve ekonomik të administruara nga doganierët e Zyrës së Mbikëqyrjes së Regjimeve (RPA-së), nuk janë të pajisura me dokumente origjinale si autorizimet e miratuara nga DPD, deklaratat e shoqërive të noterizuara, deklaratat e shoqërive për

koeficientet e shfrytëzimit të lëndëve të para, raportet për verifikimin e koeficienteve të shfrytëzimit, raportet e asgjësimit të mbetjeve nën kontrollin doganor dhe deklaratat doganore përkatëse. Mungonin faturat e shlyerjes ose, nëse duhet kërkesën për shlyerje të paraqitur nga subjekti në përputhje me pikat 300 dhe 321 të Dispozitave Zbatuese të KD, verifikimi pas zhdoganimit ose fatura e shlyerjes për sistemin me pezullim dhe kërkesës për shlyerje, për sistemin me rimbursim, shkeljet dhe kundërvajtjet doganore të zbuluara së bashku me gjobat përkatëse që janë zbatuar, raportet për çdo kontroll të kryer pranë shoqërisë dhe dokumentin e mbylljes së autorizimit të miratuar, veprim që bie ndesh me kërkesat e legjislacionit doganor, të përshkruar hollësisht në udhëzimin nr. 1, datë 06.09.2012 të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave “Për zbatimin praktik të regjimit të përpunimit aktiv”, neni 15.

U konstatua se dosjet subjekteve që kanë operuar në Regjimin e Përpunimit Aktiv, të cilat janë mbyllura gjatë vitit 2014, deri në datën 04.06.2015 nuk janë dorëzuar në Arkivin e Degës së Doganës Tiranë, veprim që bien ndesh me kërkesat e udhëzimit nr. 1 datë 06.09.2012 të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, “Për zbatimin praktik të Regjimit të Përpunimit Aktiv”, neni 15, pikat 2 dhe 3, ku theksohet se; “dokumenti i mbylljes së regjimit depozitohet nga operatori ekonomik dhe miratohet nga doganieri mbikëqyrës dhe Kryetari i Degës Doganore, *trajtuar më hollësisht në faqet nr. 57-84, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*.

Për sa më sipër është rekomanduar që, Autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Tiranë të realizojë kryerjen e inventarëve fizike brenda një afati të shkurtër, në të gjitha ambientet e operatorëve ekonomik përfitues të Regjimit të Përpunimit Aktiv dhe Magazinave Doganore në bashkëpunim dhe me strukturat e specializuara të DPD-së. Të unifikohet periodiciteti i realizimit në vijimësi të kësaj praktike.

Në Vijimësi

Autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Tiranë të marrin masat e duhura për plotësimin e të gjitha mangësive të konstatuara në dosjet e operatorë ekonomik praktikë që do të mundësojë mbajtjen në mbikëqyrje të plotë të Regjimeve të Përpunimit Aktiv dhe Magazinave Doganor. Të marrin masat e duhura që dosjet e operatorë ekonomik të mbyllura gjatë periudhës, të inventarizohen dhe arkivohen sipas kërkesave ligjore në fuqi.

Menjëherë

6. Nga auditimi u konstatua se gjendja e borxhit doganor në fillim të vitit 2014 ka qenë 1,807,618 mijë lekë, kurse në fund të vitit 2014 ajo ka arritur në vlerë 3,400,073 mijë lekë. Gjendja në fund të periudhës paraqitet me shtesë në 520 raste për 355 subjekte debitorë, **në vlerë 1,592,455 mijë lekë rritje të nivelit të borxhit doganor**. Shifrat e mësipërme tregojnë për punën e pa organizuar që ka bërë Dega e Doganës Tiranë në drejtim të rikuperimit të borxhit doganor. Nga ana tjetër konstatuam se për rikuperimin me forcë të borxhit doganor janë nxjerrë 381 vendime për sekuestrimin e mallrave të subjekteve debitorë në vlerë 2,485,138 mijë lekë ose në masën 73 % të borxhit në total, por ecuria e këtyre masave nuk ka qenë në nivelin e parashikuar, për arsye të mungesës së bashkëpunimit me strukturat e specializuara të DPD dhe institucioneve përkatëse, veprime që bien ndesh me kërkesat e ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 245, VKM nr. 205, datë 13.04.1999 Për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor” të konkretizuara në udhëzimin nr. 6, datë 23.07.2013 “Për zbatimin praktik të procedurës së evidentimit, kontabilizimit dhe vjeljes së borxhit doganor dhe akcizës”.

Nga auditimi u konstatua se nuk ka përgjegjësi të qartë lidhur me ndjekjen e vendimeve administrative të nxjerra nga autoriteti doganor kompetent. Përgjegjësia është e shpërndarë në sektorin e financës, tek juristët e doganës dhe në Zyrën e Borxhit doganor, duke vështirësuar jo

vetëm administrimin por dhe ndjekjen e këtyre vendimeve, *trajtuar më hollësisht në faqet nr. 84-85, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Për sa më sipër është rekomanduar që, Autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Tiranë në bashkëpunim me strukturat e specializuara të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe institucionet e tjera shtrënguese shtetërore të marrin masa të plota për zbatimin e të gjitha vendimeve sekuestro të nxjerra në vlerë 2,485,138 mijë lekë. Kërkojmë një vëmendje maksimale të autoritetit doganor për ndjekjen e borxhit doganor duke synuar trajtimin profesional të rasteve që zënë dhe peshën më të madhe në këtë borxh.

Në Vijimësi

Autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Tiranë të përcaktojë një përgjegjësi konkrete për inventarizimin dhe administrimin e vendimeve të nxjerra, që do të ndjek më pas dhe arkivimin e tyre në arkivin e doganës.

Menjëherë

7.1 Konstatohet se megjithëse kanë kaluar mbi dy vjet e gjysëm nga hyrja në fuqi e legjislacionit për akcizën dhe transferimin e administrimit të saj nga DPT në DPD, akoma nuk ka përfunduar procesi i kalibrimit i të gjithë kontejnerëve të depozitimi, të depozitave dhe silloseve të administrimit të mallrave nga ana Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë, veprime të cilat bien ndesh me kërkesat e ligjit nr 61/2012 datë 24/05/2012 "Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë" nenin 20 , pika c "Të përmbushë të gjitha kërkesat e vendosura nga administrata doganore për mbikëqyrjen e magazinave fiskale" dhe në kërkesat e vendimit të Këshillit të Ministrave nr 612 datë 05/09/2012 " Për dispozitat zbatuese të ligjit për Akcizat në RSH", neni 51 pika dh/e për kalibrimin dhe certifikimin e kontejnerëve (Depozita, Sillose) nga operatorë tregtare që merren me prodhimin dhe administrimin e produkteve që trajtohen me akcizë, *trajtuar më hollësisht në faqet nr. 135-149, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

7.2 Konstatohet se Sektori i Akcizës pranë Degës Doganës Tiranë, për periudhën në auditim nuk ka kryer kontrole të plota administrative dhe veçanërisht inventar fizikë vjetore në të gjitha ambientet e Depozituesve të Miratuar (Prodhim Birre) me qëllim kontrollin fizik të mallrave që trajtohen me akcizë, veprim i cili bie ndesh me kërkesat e ligjit 61/2012 "Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë", neneve 44, 45, 46 dhe 47, *trajtuar më hollësisht në faqet nr. 135-149, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

7.3 Dega e Doganës Tiranë, megjithëse kanë kaluar mbi dy vjet nga hyrja në fuqi e legjislacionit për akcizat dhe transferimin e administrimit të tyre nga DPT në DPD, nuk ka vendosur akoma personel doganor në ambientet e subjekteve që kanë përfituar statusin e Depozituesit të Miratuar dhe që rezultojnë me risk ose që kanë historik shkeljesh, veprim i cili bie ndesh me kërkesat e ligjit nr. 61/2012 "Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë i ndryshuar", nenit 44 "Atributet dhe Kompetencat", *trajtuar më hollësisht në faqet nr. 135-149, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

7.4 Konstatohet mungesa e një stafi të kualifikuar, inxhinier teknolog apo kimist pranë Sektorit të Akcizës, për të dhënë mendime dhe gjykime në drejtim të zbatimit dhe verifikimit gjatë miratimit paraprak të Kartave Teknologjike të Prodhimit, përpara Dhënies së Autorizimit, si dhe gjatë aktivitetit tregtar të subjekteve me statusin e Depozituesit të Miratuar, me qëllim njohjen dhe ndjekjen sa më korrekt të ligjit nr. 61/2012 "Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë, si dhe të VKM-

së nr. 612, datë 05.09.2012 "Për dispozitave zbatuese të ligjit për akcizat", *trajtuar më hollësisht në faqet nr. 135-149, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Për sa më sipër është rekomanduar që, Autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Tiranë të marrë masa të menjëhershme për përfundimin e procesit të kalibrimit të kontejnerëve, depozitave dhe silloseve në të gjithë operatorët ekonomik në administrim të saj.

Deri më 25.12.2014

Autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Tiranë në bashkëpunim me strukturat e specializuara të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave të marrë masa për e inventarizimit fizikë të mallrave objekt akcize në ambientet e Depozituesve të Miratuar. Të marren masa për vendosjen e personelit në ambientet e subjekteve që kanë përfituar statusin e Depozituesit të Miratuar dhe që rezultojnë me risk apo që kanë historik shkeljesh.

Në Vijimësi

Autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Tiranë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave të marrë masa për ngritjen e kapaciteteve që janë në përbërje të Sektorit të Akcizës, duke plotësuar strukturat edhe me specialist inxhinier teknolog-kimist, duke forcuar dhe mbikëqyrur më profesionalisht realizimin e akcizës.

Në Vijimësi

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Të kërkohet në rrugë ligjore arkëtimi i vlerës prej **130,438 mijë lekë** duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit, si më poshtë:

1. Vlera prej 14,173 mijë lekë detyrime nga 68 subjekte sipas aneksit nr. 1, trajtuar në faqet 18-56 të RPA, për mos llogaritje dhe mos arkëtim të detyrimeve doganore sipas Kodit Doganor, për pranim të vlerës së transaksionit jo në përputhje me kërkesat dhe kriteret ligjore për vitin 2014.

Deri më datë 30.12.2015

2. Vlera prej 57,581 mijë lekë detyrime dhe penalitete nga 41 subjekte sipas Aneksit 3, trajtuar në faqet 135-149 të RPA, për shkelje të ligjit nr. 61/212, datë 24.05.2012 "Për Akcizat" dhe për mos zbatim gjobash, për vitin 2014.

Deri më datë 30.12.2015

3. Vlera prej 1,050 mijë lekë penalitete nga 24 subjekte sipas aneksit nr. 5, trajtuar në faqet 57-84 të RPA, për shkelje të konstatuara nga auditimi i Regjimit të Përpunimit Aktiv, për vitin 2014.

Deri më datë 30.09.2015

4. Vlera prej 31,970 mijë lekë detyrime dhe penalitete nga 3 subjekte të TVSh-së, sipas aneksit nr. 4, trajtuar në faqen 149 të RPA rezultuar nga mos zbatimin e afateve kohore për zbatimin e skemës së pagesës të TVSH-së së shtyrë, për vitin 2014.

Deri më datë 30.09.2015

5. Vlera prej 24,464 mijë lekë detyrime dhe penalitete të pa zbatuara nga shkeljet e legjislacionit doganorë gjatë nxjerrjes së vendimeve administrative për 53 subjekte, sipas aneksit 2, trajtuar në faqet 85-135 të RPA, për vitin 2014.

Deri më datë 30.09.2015

6. Vlera prej 1,200 mijë lekë penalitete nga 24 subjekte të Regjimit të Magazinës Doganore sipas aneksit nr. 6 trajtuar në faqet 56-57 të RPA, për vitin 2014.

Deri më datë 30.09.2015

C. MASA DISIPLINORE

C. 1 Mbështetur në nenin 59, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i është rekomanduar Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave dhe Drejtorit të Doganës Tiranë, që në vlerësim të shkeljeve të mëposhtme, të konsideruara nga ana jonë si shkelje të rënda dhe shumë të rënda, të bëjë klasifikimin e tyre dhe të urdhërojë fillimin e procedurave përkatëse sipas **pikës 1 të nenit 57** të ligjit nr. 152/2013, për shqyrtimin dhe dhënien e masave nga **“vërejtje”**, deri në **“largim nga shërbimi civil”** për **2 (dy)** nëpunës civil të Degës Doganës, Tiranë si më poshtë:

1. Znj. [REDAKTUAR], Doganier klasifikim/vlerësimi
2. Znj. [REDAKTUAR], Doganier klasifikim/vlerësimi

C. 2 Mbështetur në nenin 59, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i është rekomanduar Drejtorit të Doganës Tiranë, që në vlerësim të shkeljeve të mëposhtme, sipas pikës 1 të nenit 57 të ligjit nr. 152/2013, të fillojë procedurat për shqyrtimin dhe dhënien e masave përkatëse, sipas nenit 59.2 të ligjit nr. 152/2013:

Neni 58, germa (a) “vërejtje”, për 6 (gjashtë) nëpunës civilë si më poshtë:

3. Znj. [REDAKTUAR], Doganier klasifikim/vlerësimi
4. Z. [REDAKTUAR], Doganier klasifikim/vlerësimi

Për veprime në kundërshtim me ligjin nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, të pikës 15.13 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 205, datë 13.04.1999 “Për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor”, si dhe të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 25 datë 30.11.2007 “Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore burimet e informacionit dhe afatet e publikimit të dosjes me të dhëna të disponueshme”, nuk kanë aplikuar vlerat e të dhënave të disponueshme. *(Trajtuar në faqet 18-56 të RPA)*

Për veprime në kundërshtim me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave nr. 779 datë 16.01.2013 “Mbi rishikimin e disa indikatorëve kontrolli shtesë në vlerësimin doganor të mallrave me orgjinë nga vendet jashtë BE, nuk kanë aplikuar vlerat e indikatorëve shtesë

Për veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për Taksat Kombëtare” i ndryshuar, udhëzimit nr. 26, datë 04.09.2008 të Ministrit të Financave “Për Taksat Kombëtare” i ndryshuar, nuk kanë vjelë detyrimet për taksën e ambalazhit

Për veprime në kundërshtim me nomenklaturën e miratuar me VKM nr. 1067, datë 14.12.2013, “Për miratimin dhe publikimin zyrtar të nomenklaturës së kombinuar të mallrave 2014”, dhe të Rregullave të përgjithshme për interpretimin e nomenklaturës së kombinuar, nuk kanë aplikuar saktë tarifatat doganore të mallrave.

5. Z. [REDAKTUAR], Doganier në zyrën e mbikëqyrjes të regjimit të përpunimit aktiv
6. Z. [REDAKTUAR], Doganier në zyrën e mbikëqyrjes të regjimit të përpunimit aktiv

Për veprime në kundërshtim me ligjin nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 272 pika 1 dhe 2, për mos vendosje të sanksioneve për shkeljet e konstatuara. *(Trajtuar në faqet 56-84 të RPA)*

7. Znj. [REDAKTUAR], juriste
8. Znj. [REDAKTUAR], juriste

Për veprime në kundërshtim me ligjin nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, VKM nr. 205, datë 13.04.1999 mbi “Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor”, i ndryshuar. Nga auditimi i vendimeve administrative të mara nga autoriteti doganor kompetent gjatë marjes së vendimeve u konstatuan disa shkelje të legjislacionit doganor (*Trajtuar në faqet 85-135 të RPA*)

C. 3 Mbështetur në nenin 59, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i është rekomanduar Drejtorit të Doganës Tiranë, që në vlerësim të shkeljeve të mëposhtme, sipas pikës 1 të nenit 57 të ligjit nr. 152/2013, të fillojë procedurat për shqyrtimin dhe dhënien e masave përkatëse, sipas nenit 59.2 të ligjit nr. 152/2013:

Neni 58, germa (ç) “largim nga shërbimi civil”, për 2 (dy) nëpunësit civilë si më poshtë:

1. Z. [REDAKTUAR], ish- Kryetar
2. Z. [REDAKTUAR], ish- Jurist

Për veprime në kundërshtim me ligjin nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, VKM nr. 205, datë 13.04.1999 mbi “Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor”, i ndryshuar. Nga auditimi i vendimeve administrative të mara nga autoriteti doganor kompetent gjatë marjes së vendimeve u konstatuan disa shkelje të legjislacionit doganor (*Trajtuar në faqet 85-135 të RPA*).

Shënim: Për punonjësit e tjere të cilët janë përmendur në Raportin Përfundimtar të Auditimit, për mangësi në zbatimin e detyrave funksionale, në raste të veçanta, grupi i auditimit nuk del me rekomandim për masë disiplinore.

Ndërsa, për 6 (gjashtë) punonjës nuk rekomandohen masa disiplinore, për arsye se kanë shkëputur marrëdhëniet me institucionin.

D. KALLZIM PENAL

D. Bazuar në nenin 281, të ligjit nr. 7905, datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, VKM nr. 205, datë 13.04.1999 mbi “Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor”, KLSH me shkresën nr. 409/15, datë 08.09.2015, ka depozituar pranë organit të Prokurorisë kallëzim penal për:

1. Z. [REDAKTUAR], ish-Kryetar i Degës së Doganës Tiranë dhe
2. Z. [REDAKTUAR], ish-jurist në Degën e Doganës Tiranë

Të cilët në mospërmbyllje të detyrës së tyre, kanë konsumuar elementët e veprës penale të “Shpërdorimit të detyrës në marjen e vendimeve administrative”, parashikuar nga neni 248 dhe 258 i Kodit Penal, në lidhje me vendimet nr. 5041 datë 03.06.2014, nr. 4753, datë 03.06.2014, nr. 5053, datë 03.06.2014, nr. 3802/1, datë 02.05.2014, 5896, datë 26.06.2014, nr. 5099.1, datë 07.06.2014, nr. 5173 datë 09.06.2014, nr. 4889, datë 03.06.2014, nr. 4371, datë 03.06.2014, nr. 4813, datë 03.06.2014, nr. 4371, datë 03.06.2014, nr. 3650 datë 25.04.2014.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të të Ardhurave të Buxhetit të Shtetit.

Shënim: Auditimi u krye përgjatë periudhës 20.04.2015 deri 24.06.2015, nga audituesit Vullnet Karafilaj, Përgjegjës grupi, Altin Dinaj, Livan Hoxha dhe Ornela Ymeri, anëtarë, u shqyrtua nga Drejtori i Departamentit zj. Albana Agolli dhe Drejtori i Departamentit Juridik dhe Kontrollit te Zbatimit te Standardeve z. Ermal Yzeiraj.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT